

**AKT I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"EVOLUTION NETWORK" SH.P.K**

**NENI 1
EMRI I SHOQËRISË**

- 1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "EVOLUTION NETWORK" SH.P.K (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

**NENI 2
SELIA**

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në Rrugën Ismail Qemali, Objekt me nr.pasurie 3/102, Zona Kadastrale 8270 Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Ortaku i Vetëm mund të vendosë për transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë ka të drejtë të çelë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe jashtë.

**NENI 3
KOHËZGJATJA**

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore prej 10 vjetësh nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar.

**NENI 4
OBJEKTI I SHOQËRISË**

- 4.1 Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të lejuar nga ligji në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në:
- a) Shërbime promovimi dhe shitje produktesh e shërbimesh nëpërmjet telefonit apo forma të tera komunikimi;
 - b) Administrim call center dhe i çdo aktiviteti tjetër të lidhur me apo që ka për qëllim këtë veprimtari;
 - c) Aktivitete shitblerje mallrash dhe shërbimesh, përfshirë eksporti dhe importi i produkteve dhe shërbimeve;
 - d) Shitblerje pasurish të paluajtshme;
 - e) Prodhim dhe shitje programesh informatike dhe aplikacione;
 - f) Investime në aktivitete prodhuese dhe industriale;
 - g) Kërkime tregu.
- 4.2 Me qëllim kryerjen e aktiviteteve të mësipërme, Shoqëria mund të ushtrojë veprimtarinë e saj në Shqipëri dhe jashtë saj e të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës, të ngjashëm, plotësues apo të dobishëm për përmbushjen e objektit të saj. Për përmbushjen e objektit të saj, Shoqëria mund të:
- a) zotërojë direkt ose indirekt pjesëmarrje në shoqëri dhe/ose sipërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose që mund të ndihmojnë në realizimin e objektit



- të Shoqërisë;
- b) kryejë çdo aktivitet e transaksion tregtar, në lidhje me pasuri të luajtshme e të paluajtshme;
 - c) japë dorëzani, hipoteka, garanci reale dhe/ose personale;
 - d) themelojë degë, zyra përfaqësimi dhe në përgjithësi të kryejë çdo aktivitet tjetër që nuk është i ndaluar nga ligji.

NENI 5

KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali, i Shoqërisë është i barabartë me 10.000 Lekë (dhjetë mijë Lekë). Kapitali i regjistruar është plotësisht i nënshkruar dhe i ndarë në një kuotë, që përfaqëson 100% të kapitalit, me vlerë 10.000 Lekë (dhjetë mijë Lekë), e zotëruar nga Ortaku i Vetëm Z.Umberto Cervelli, shtetas italian, lindur në Rome, më 27/10/1973, me banim në Rome, me kartë identiteti nr. AV3033984.

NENI 6

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet në çdo moment me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*". Në çdo rast kapitali i regjistruar nuk mund të zvogëlohet nën kufirin minimal të parashikuar nga ligji.

NENI 7

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 7.1 Në përputhje me nenin 81, pika 3, e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", Ortaku i Vetëm ushtron të gjitha të drejtat dhe kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Në mënyrë të veçantë, duhet të regjistrohen vendimet e mëposhtme për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve,
 - c) vendime për investime;
 - d) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
 - e) marrjen përsipër të detyrimeve nga Shoqëria për shumat mbi 15.000 Euro për çdo veprim ose nëse tejkalojnë shumën totale 15.000 Euro në një vit kalendarik.
- 7.2 Çdo vendim i Ortakut të Vetëm që nuk është regjistruar në regjistrin e vendimeve do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm. Ortaku i Vetëm vendos për të gjitha çështjet e parashikuara në nenin 81 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*".



- 73 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencë dhe/ose videokonferencë, në përputhje me ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet, Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 74 Asambleja Përgjithshme mund të thirret nga administratori/ët ose ortakët e Shoqërisë, në përputhje me parashikimet e nenit 84 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.20 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe sa herë që thirrja është e detyrueshme sipas ligjit. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të behet nepermjet njoftimit me shkrim, telefax ose letërporosi, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht në rast se, pavarësisht respektimit të formaliteteve të mësipërme, të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë dakord për rendin e ditës dhe të marrin vendime për çështjet përkatëse.
- 75 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Kryetari, i zgjedhur ndërmjet të pranishmëve. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.
- 76 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të finnosin nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 77 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 8 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 8.1 Shoqëria do të administrohet nga një administrator i vetëm i zgjedhur nga Ortaku i Vetëm për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori i vetëm rizgjidhet ose shkarkohet nga Ortaku i Vetëm. Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë Z.Klajdi Zana, lindur në Lushnje më 28/08/1983, me letërnjoftimin nr. 130828059G, i caktuar në detyrë nga data e këtij e për 5 vitet pasuese.
- 8.2 Organi i administrimit zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç atyre akteve që janë në kompetencën e Ortakut të Vetëm. Do të miratohen paraprakisht me shkrim nga Ortaku i Vetëm të gjitha veprimet e administratorit të vetëm që sjellin një angazhim/detyrim për Shoqërinë për shumat mbi 15.000 Euro për çdo veprim ose nëse tejkalojnë shumën totale 15.000 Euro në një vit kalendarik. Administratori mban përgjegjësi

për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të delegojë të tretë për të kryer veprime dhe akte të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Në çdo rast, administratori do të jetë përgjegjës për veprimtarinë e të tretëve që ka autorizuar.

- 8.3 Administratorët nuk mund të marrin hua nga Shoqëria apo të lëshojnë garanci, dorëzani në emër dhe për llogari të Shoqërisë, për hua dhe financime të dhëna nga te tretët.
- 8.4 Ortaku i Vetëm përcakton shpërblimin e organit administrues të Shoqërisë. Organi administrues do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti interesi, administratori i përfshirë do të njoftojë menjehere Ortakun e Vetëm si edhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me situatën e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Ortaku i Vetëm.

NENI 9

VITI FINANCIAR

- 9.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 10

KONTROLLI FINANCIAR

- 10.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Ortaku i Vetëm do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në të gjitha ato raste kur emërimi konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet nga ligji.

NENI 11

BILANCI VJETOR

- 11.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit të administrimit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Ortaku i Vetëm.
- 11.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Ortaku i Vetëm brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 12

DIVIDENDI

- 12.1 Ne përputhje me dispozitat e ligjit, Ortaku i Vetëm vendos mbi shpërndarjen e dividendit në bazë të rezultatit financiar të Shoqërisë.

NENI 13

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 13.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Ortakut të Vetëm dhe administratorit të Shoqërisë do të jenë fillimisht objekt konsultimi miqësor mes palëve, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve nga lindja e mosmarrëveshjes apo nga data kur mosmarrëveshja është komunikuar me shkrim nga njëra nga palët. Në rast

mosmarrëveshja nuk do të zgjidhet miqësisht, mosmarrëveshja do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 14
GJUHA

14.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet nga Ortaku i Vetëm në 4(katër) ekzemplarë në gjuhën shqipe.

NENI 15
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

15.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe ligjin shqiptar në fuqi. Për sa nuk është parashikuar në këtë statut do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Lexuar, miratuar dhe nënshkruar më datë 22/03/2018 në Tiranë, Shqipëri.

ORTAKU I VETËM

Z. Umberto Cervelli

UMBERTO CERVELLI
U. Cervelli

Përktheu në italisht

Klejdi Pano
Klejdi Pano